



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, nenit 8 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 e datës 28.06.2019, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, duke vendosur sipas kërkesës Nr.1-400-2992 të datës 15.01.2020 të Shoqatës së "Minatorëve dhe Pensionistëve" dega në Lipjan, Kryetari i Komunes nxjerr:

**VENDIM  
PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE**

**Neni 1**

I ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej 500 € (pesëqind euro), Shoqatës së Minatorëve dhe Pensionistëve invalid të Lipjanit, sipas kërkesës së tyre Nr.1-400-2992 të datës 15.01.2020 për realizimin e aktivitetit Ditët e Minatorëve.

**Neni 2**

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2020 pozicioni buxhetor- subvencionet e planifikuara për Zyrën e Kryetarit të Komunës në xhironlogarinë bankare të Shoqatës së Minatorit në Lipjan në nr.1907001134031173 në BKT bankë.

**Neni 3**

Lidhur me mjetet e shpenzuara e lartëcekura duhet të sjell dëshmi-faturë deri në shumën e lejuar dhe të njëjtat ti dorëzojë në Sektorin për përfaqësim dhe çështje ligjore më së largu me datë 08.04.2020.

**Neni 4**

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit të Komunës dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

**Neni 5**

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Shoqata Minatori në Lipjan.

1Nr.400-2992

Lipjan, më 25.02.2020

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti

